



Prishtinë: 23.06.2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1257\_2020

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e ZRRE-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_R\_2051\_03\_20** .

në seancën e mbajtur më datë 23.06.2020 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit S.R. nga Komuna e Prishtinës si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij rekomandimi.

### A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) është parashtruar ankesa nga konsumatori S.R. me shifër **DPR- 90076758** me të cilën është kundërshtuar përgjigja e lëshuar nga KESCO, lidhur me kontestimin e korrjigimit plotësues 91347DPR-90076758 datë 11.10.2017, për shkak të matjes jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 51285122.

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Me datë 13.07.2017 konsumatori ka bërë kërkesë zyrtare në KESCO për ndërrim –kalibrim-shqyrtim të njehsorit elektrik.

**Provë:** Aplikacioni për ndërrim dhe shqyrtim njehsori i datës 13.07.2017

Me datë 13.07.2017 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.51285122 gjendja e shpenzimeve nuk evidentohet pasi që njehsori është i djegur tërësisht, si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr.51285090 me gjendje TL=03746,985 kWh dhe TU=00678,543 kWh, si dhe R1=00414,206 dhe R2=00293,010.

**Provë:** Procesverbali – Protokoli mbi montimin–demontimin dhe ndërrimin e grupit matës nr. 0026453 i datës 13.07.2017

Me datë 27.07.2017 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes për njehsorin elektrik nr. 51285122 ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik nuk është në rregull, njehsori elektrik është i djegur, njehsori elektrik nuk i ka bllobat (vulat) shtetërore, njehsori elektrik është i dëmtuar nga ana e jashtme, nuk ka probleme me sistemet matëse. Gjithashtu është evidentuar vërejtja që njehsori elektrik i mungon një bllobë, si dhe nga ana e epërme është i djegur.

**Provë:** Procesverbali i shqyrtim të njehsorit elektrik nr.org. 02 nr.13818 i datës 02.08.2017



Departamenti i faturimit në KESCO me datë 11.10.2017 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjim plotësues nr.91347DPR-90076758 në vlerë financiare **895.42€** duke bërë korrigjimin plotësues për faturën e periudhës 07/2017.

**Provë:** Korrigjimi 91347DPR-90076758 i datës 11.10.2017

Me datë 16.11.2017 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrigjimin plotësues 91347DPR-90076758 datë 11.10.2017.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit datë 11.10.2017

Me datë 25.11.2017 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe Procesverbalit – Protokolit mbi montimin–dëmontimin dhe ndërrimin e grupit matës nr. 0026453 të datës 13.07.2017.

**Provë:** Përgjigja e KESCO-s e datës 25.11.2017

Me datë 05.12.2017 konsumatori ka parashtruar ankesë në ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar ti shqyrtohet korrigjimi plotësues nr.91347DPR-90076758 datë 11.10.2017.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në ZRRE me datë 05.12.2017

Bordi i ZRRE pas analizave të të gjitha dëshmimeve të paraqitura nga konsumatori dhe KESCO/KEDS, ka vërejtur se:

Me datë 13.07.2017 konsumatori ka bërë kërkesë zyrtare në KESCO për ndërrim –kalibrim-shqyrtim të njehsorit elektrik. Bazuar në kërkesën e konsumatorit, punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori me datë 13.07.2017 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.51285122 gjendja e shpenzimeve nuk evidentohet pasi që njehsori është i djegur tërësisht, si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr.51285090 me gjendje TL=03746,985 kWh dhe TU=00678,543 kWh si dhe R1=00414,206 kVAr dhe R2=00293,010 kVAr.

**Provë:** Aplikacioni për ndërrim dhe shqyrtim njehsori datë 13.07.2017 dhe procesverbali – Protokoli mbi montimin–dëmontimin dhe ndërrimin e grupit matës nr.0026453 i datës 13.07.2017

Me datë 27.07.2017 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes për njehsorin elektrik nr.51285122 ku kanë konstatuar se: “njehsori elektrik nuk është në rregull, njehsori elektrik është i djegur, njehsori elektrik nuk i ka bllombat (vulat) shtetërore, njehsori elektrik është i dëmtuar nga ana e jashtme, nuk ka probleme me sistemet matëse. Është evidentuar vërejtja që njehsori elektrik i mungon një bllombë si dhe nga ana e epërme është i djegur”.

**Provë:** Procesverbali i shqyrtim të njehsorit elektrik nr. Org. 02 nr. 13818 datë 27.07.2017

Me datë 11.10.2017 Departamenti i faturimit në KESCO bazuar në procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik nr.51285090 ka bërë korrigjimin plotësues nr.91347DPR-90076758 në vlerë **895.42€** për faturën 07/2017 duke ri faturuar faturën e asaj periudhe (periudhën 01.07.2017 deri me 13.07.2017) për shkak të djegies të njehsorit elektrik nr.51285090 me datë 13.07.2017. Bordi i ZRRE ka shqyrtuar korrigjimin plotësues të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar bazuar në procedurat dhe kodet në fuqi sipas së cilave në rastet kur konstatohet se ka defekt në sistemin matës, atëherë duhet të bëhen të gjitha korrigjimet e nevojshme duke bërë ri llogaritjen e energjisë përkatësisht përmirësimi i faturimit. Duke pasur parasysh që njehsori i konsumatorit lexohet nga distanca përkatësisht përmes AMR, Bordi i ZRRE ka analizuar edhe të gjitha leximet/regjistrimet e bëra në njehsorin nr.51285090 dhe konstaton se ato lexime të shpenzimeve janë të sakta deri në momentin e djegies së njehsorit ku gjendja e fundit e regjistruar është AT1= 2269.75 kWh, AT2=260.6 kWh, RT1=1565.926 kVAr dhe RT2=128.2978 kVAr. Gjithashtu Bordi i ZRRE ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike para, gjatë periudhës kontestuese dhe pas periudhës kontestuese dhe ka vërejtur se po që shpenzimit të energjisë elektrike të periudhës kontestuese 8, pra nëse faturimit të shpenzimit të energjisë elektrike të periudhës 07/2017 i shtohet edhe pjesa e



korrigjimit shtese atëherë rezulton se ky shpenzim përputhet me shpenzimin e energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese.

**Provë:** Korrigjimi plotësuese nr.91347DPR-90076758 i datës 11.10.2017

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 23.06.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit: S. R.
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.